



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 tetor 2011  
Nr. ref.:145/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUSHMËRI**

në

**Rastin Nr. KO 43/10**

Parashtruesi

**LDK-AAK-LDD, KK-Prizren**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të akteve juridike të nxjerra nga Kryetari i  
Komunës së Prizrenit**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

Me shumicë votash miraton vendimin mbi papranueshmërinë, që ka të bëjë me kërkesën.

#### **Parashtruesit e kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë grupet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nga radhët e LDK-së, AAK-së dhe LDD-së, të përfaqësuara me autorizim nga z. Ridvan Hoxha, kryetar i grupit të anëtarëve të LDK-së në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

## Aktet e sfiduara

2. Aktet e sfiduara në Gjykatën Kushtetuese janë:

- Vendimi për emërimin e dy nënkryetarëve të Komunës, z. Arsim Shpejti dhe z. Ruzhdi Rexha, nga komuniteti shumicë;
- Vendimi për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave fillore e të mesme në Prizren;
- Konkursi i shpallur në gazetat ditore, i datës 9.02.2010; dhe
- Aktvendimi i datës 01.03.2010 për përfundimin e marrëdhënies së punës për z. Isa Osmankaj-menaxher i prokurimit në Komunën e Prizrenit, të gjitha të nxjerra nga Kryetari i Komunës së Prizrenit.

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 18 qershor 2010, të plotësuar me kërkesat shtesë të 19 gushtit 2010 dhe 1 shtatorit 2010, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, z. Ramadan Muja, lidhur me emërimin e dy nënkryetarëve të komunës nga radhët e komunitetit shumicë në Prizren, të vendimit për emërimin e drejtorëve të shkollave të mesme dhe fillore të Komunës së Prizrenit, të aktvendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shërbyes civil në komunë, si dhe për bllokadën e punës së Kuvendit Komunal, duke anashkaluar ligjet në fuqi dhe Kushtetutën e Republikës.

4. Shkeljet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka bërë Kryetari i Komunës së Prizrenit janë:

**Neni 123** 1. *E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj; dhe*

**Neni 124** 6. *Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.*

## Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe neni 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

## Përmbledhje e procedurës në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 18 qershor 2010, të plotësuar me kërkesat shtesë të 19 gushtit 2010 dhe 1 shtatorit 2010.

7. Kërkesa iu komunikua Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejshëm: MAPL) më 3 gusht 2010, e cila ia dorëzoi komentet e veta Gjykatës më 27 gusht 2010. MAPL në shkresën e vet thekson se i ka shqyrtuar dhe është përgjigjur në ankesat e parashtruara nga grupet e deputetëve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, dhe me shkresën shpjeguese 102-138 të 24 shkurtit 2010, u ka shpjeguar kryetarëve të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës mënyrën ligjore të rritjes së numrit të drejtorive komunale, sepse monitoruesit e MAPL-së e kishin vërejtur se ka komuna ku Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe statutet komunale nuk janë respektuar. MAPL, gjithashtu, theksoi se me aktin I. nr 02-312 të 23 prillit 2010, të nënshkruar nga Ministri i MAPL-së, z. Sadri Ferati, ka kërkuar nga z. Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit, që të rishqyrtojë vendimin për emërimin e nënkryetarëve të Komunës. Një kopje e kësaj shkrese i është dërguar edhe z. Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit Komunal në Prizren, ndërsa në lidhje me kërkesën që MAPL të sqarojë rregullsinë e votimit lidhur "votëbesimin e kryesuesit të Kuvendit Komunal", MAPL

kishte sqaruar se në mbledhjen e KK-së të mbajtur më 19 maj 2010, nga 41 deputetë, sa ka KK-ja, në mbledhje kanë marrë pjesë 40 dhe se propozimi për votëbesimin (shkarkimin) e kryesuesit të KK-së ka marrë 20 vota për, e janë nevojitur 21 vota. Ministria e Pushtetit Lokal, shkresës së dërguar në Gjykatë ia bashkëngjiti edhe korrespondencën midis MAPL-së dhe parashtruesit të kërkesës.

8. Më 14 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka marrë përgjigje nga Kryetari i Komunës së Prizrenit lidhur me kërkesën e grupit të deputetëve të Kuvendit Komunal të Prizrenit me anë të së cilës kontestohet kërkesa, si në aspektin e pranueshmërisë ashtu edhe në atë të themelësisë. Kryetari Muja ka theksuar se ai nuk mund të jetë palë në procedurë, sepse sipas ligjit për V. L. komuna ka statusin e personit juridik dhe ajo “mund të padisë dhe të paditet” dhe jo Kryetari i Komunës. Gjithashtu, më tej z. Muja ka kontestuar edhe legjitimitetin e parashtruesve të kërkesave duke theksuar se atyre nuk iu janë shkelur të drejtat dhe liritë individuale, sikur parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe duke pohuar se palët kanë tejkaluar afatin ligjor prej 4 muajsh për parashtrim të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 22 shkurt, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Gjyljeta Mushkolaj, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy, kryetar, dhe Almiro Rodriges e Kadri Kryeziu, anëtarë të panelit, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

### **Pretendimet e parashtruesit**

10. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se z. Ramadan Muja, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Prizrenit, duke ushtruar funksionin e tij zyrtar ka bërë shkelje të vazhdueshme të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe atë që nga fillimi i mandatit të tij. Këto shkelje të pretenduara nga parashtruesit e kërkesës janë përshkruar si në vijim:
  - Kryetari i Komunës së Prizrenit e ka bllokuar punën e Kuvendit të Komunës duke vepruar në kundërshtim me Statutin e Komunës së Prizrenit, duke mos u “kujdesur për zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të dispozitave të tjera ligjore që janë përgjegjësi e komunave”;
  - Ka bërë shkelje të nenit 60.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale duke e emëruar një nënkryetar komune më shumë nga komuniteti shumicë;
  - Ka marrë vendime arbitrare dhe joligjore për formimin e ekzekutivit komunal, respektivisht të drejtorive, pa u rregulluar kjo çështje me rregullore të veçantë;
  - I ka cenuar dispozitat ligjore në fuqi për emërimin e drejtorëve të shkollave;
  - Ka marrë vendim politik për largim nga puna të shefit të Zyrës së prokurimit pa procedurë paraprake të përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës;
  - Së bashku me Kryesuesin (e Kuvendit të Komunës), z. Nijazi Kryeziu, kanë pamundësuar funksionimin e Kuvendit të Komunës, dhe se i njëjti që nga mbledhja e parë konstituive, më 15 shkurt 2010, ka mbajtur vetëm dy mbledhje të jashtëzakonshme të kërkuara nga opozita në Kuvendit Komunal; dhe
  - Ka bërë shkelje të tjera të legjislacionit në fuqi në Kosovë.

### **Përmbledhje e fakteve**

11. Me kërkesën e datës 18 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese të “ndërmerr masa ligjore ndëshkuese ndaj Ministrit të MAPL-së dhe Kryeministrit të Kosovës, për arsye të mosveprimit dhe heshtjes përballë veprimeve arbitrare të z. Ramadan Muja, kryetar i Komunës së Prizrenit”. Njëkohësisht, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të urdhërojë MAPL-në që të “fillojë procedurën për shkarkim

të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, duke pretenduar se z.Ramadan Muja, kryetar i Komunës së Prizrenit, ka bërë shkelje të Kushtetutës së Kosovës.

12. Një kopje të kërkesës me të njëjtat të dhëna, përfaqësuesit e partive politike të LDK-së, AAK-së dhe të LDD-së, anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ia kishin dërguar edhe Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil, në Prishtinë.
13. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, ka theksuar se grupi i anëtarëve të LDK-së, AAK-së dhe LDD-së në Kuvendin e Komunës së Prizrenit, për shkeljet e sipërsënuara, më 15 maj 2010, e kishte iniciuar procedurën e shkarkimit të Kryetarit të Komunës në bazë të nenit 64.1, 2. dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe të nenit 36 të Statutit të Komunës së Prizrenit, por që iniciativa e grupit është injoruar nga MAPL dhe Qeveria e Kosovës.
14. Parashtruesi ia ka bashkëngjitur kërkesës edhe pretendimet për shkelje të legjislacionit në fuqi nga Kryetari i Komunës së Prizrenit gjatë qeverisjes së tij dyvjeçare, por edhe gjatë mandatit të tij paraprak në periudhën 2007 – 2009, së bashku me dokumentacionin përcjellës, për të cilin pretendohet se MAPL dhe Qeveria e Kosovës kanë qenë rregullisht të informuar.
15. Më 28 korrik 2010, Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesë shtesë nga i njëjti parashtrues i kërkesës me të cilën paraqiten pretendime shtesë për shkelje të Kushtetutës dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës nga ana e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, dhe kërkohet nga Gjykata Kushtetuese që të detyrojë MAPL-në dhe Kryeministrin që të fillojë procedurën e suspendimit dhe të shkarkimit të Kryetarit të Komunës së Prizrenit në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Pretendimet shtesë janë si në vijim:
  - Kryetari i Komunës së Prizrenit “në mënyrë kundërkushtetuese dhe kundërligjore e ka firmosur dhe përcjellë për miratim në Kuvendin e Kosovës buxhetin e rishikuar të Komunës së Prizrenit për vitin 2010, pa kaluar i njëjti në procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi; dhe
  - Kryetari i Komunës së Prizrenit së bashku me Kryesuesin e Kuvendit Komunal, i cili sipas parashtruesit të kërkesës e ka humbur votëbesimin më 19 maj 2010, në mënyrë të kundërligjshme e kanë organizuar seancën e Kuvendit Komunal të Prizrenit.
16. Më 19 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e dytë shtesë nga parashtruesi i njëjtë. Me kërkesën e dytë shtesë, parashtruesi i kërkesës e ka informuar Gjykatën se Kryetari i Komunës së Prizrenit kishte organizuar konferencë për shtyp, me të cilën ishte konfirmuar mbajtja e seancës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit, për të cilën parashtruesi i kërkesës pretendon se ka qenë e paligjshme. Kërkesës ia bashkëngjet kopjet e artikujve nga dy gazeta ditore lidhur me konferencën për shtyp të Kryetarit të Komunës.
17. Më 1 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese ka pranuar kërkesën e tretë shtesë nga i njëjti parashtrues i kërkesës, të cilën e regjistron përsëri me të njëjtin numër. Me kërkesën e tretë shtesë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Kryetari i Komunës së Prizrenit i ka bërë edhe tri shkelje të tjera të legjislacionit në fuqi, si në vijim:
  - Kryetari i Komunës së Prizrenit, së bashku me Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Prizrenit, e kanë organizuar seancën e dytë të Kuvendit Komunal, më 30 gusht 2010, në kundërshtim me nenin 50 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale”. Kuvendi i Komunës së Prizrenit nuk ka mbajt seanca të rregullta për gjashtë muaj me radhë dhe si i tillë është inekzistent;

- Për arsye të mos mbajtjes së seancave të rregullta të Kuvendit mbi gjashtë muaj, statusi i këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, sipas nenit 36 (e) të LVL, është i kundërligjshëm; dhe
- Kryetari i Komunës së Prizrenit ka bërë shkelje ligjore duke e larguar shërbyesin civil nga vendi i punës pa i përfillur procedurat ligjore. Për këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës e bashkëngjet si provë Vendimin Nr. 1709 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, të datës 27 mars 2010, me të cilën vërtetohet shkelja e bërë ligjore.

### **Vlerësimi mbi pranueshmërinë**

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendos për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat për pranueshmëri të kërkesës të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Përmbushja e të gjitha kushteve në mënyrë kumulative është qenësore për të parashtruar një çështje në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë ligjore, dhe në lidhje me këtë Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës ku thuhet:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

19. Palët e autorizuar për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese janë përcaktuar me nenin 113, pikat 2-9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në fakt asnjëra nga to nuk parasheh të drejtën e deputetëve (anëtarëve), të cilitdo nga kuvendet e komunave të Kosovës, që si grup të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

20. Në fakt, Kushtetuta e Kosovës për sa i përket të drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, përkufizimit juridik “deputetëve” i referohet vetëm në pikat 5 dhe 6 të nenit 113, dhe në këtë rast e drejta për të ngritur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese i atribuohet “deputetëve të Kuvendit të Kosovës”, dhe saktësisht 10 a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë të drejtë të kërkojnë vlerësimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit të Kosovës me Kushtetutën, dhe së paku 30 deputetë, po ashtu të Kuvendit të Kosovës, mund të kërkojnë interpretim nga Gjykata nëse Presidenti i Republikës ka shkelur Kushtetutën e vendit, por jo edhe deputetët (anëtarët) e kuvendeve të komunave.

21. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë, “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”. Pra, edhe anëtarët e kuvendeve të komunave, që pretendojnë se autoritetet publike, përfshirë edhe komunën, kanë bërë shkelje të të drejtave ose të lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, kanë të drejtë ta padisin autoritetin publik.

22. Në një rast të tillë, palët do të duhej të dëshmonin se janë “palë e autorizuar” dhe se ndaj anëtarit/ve të kuvendit të komunës, respektivisht parashtruesit të kërkesës ka “shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tij individuale, të garantuara me Kushtetutë”. Parashtruesi i kërkesës, pra, do të duhej ta provojë para Gjykatës “statusin e viktimës të shkakuar me aktin e autoritetit publik” sikur është paraparë me nenin 34 të Konventes Evropine për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (shih mutatis mutandis Lindsay v. the United Kingdom, no. 31699/96, Commission decision of 17 January 1997, 23 E.H.R.R. Agrotexim and Others v. Greece, judgment of 24 October 1995, Series A no. 330-A, pp. 22-26, §§ 59-72; Terem Ltd, Chechetkin and Olius v. Ukraine, no. 70297/01, § 28, 18 October 2005; Veselá and Loyka v. Slovakia (dec.), no. 54811/00, 13 December 2005).

23. Prandaj, Gjykata qartë konstaton se parashtruesve të kërkesës u ka munguar legjitimiteti aktiv për të ngritur këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht ka pasur mungesë të locus standi, dhe për pasojë Gjykata do të duhej që kërkesën ta deklarojë të papranueshme (shih mutatis mutandis Convention (Municipal Section of Antilly v. France (dec.), no. 45129/98, ECHR 1999-VIII).
24. Në këto rrethana, kërkesa është e pabazuar dhe parashtruesi nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës, prandaj,

### **PËR KËTO ARSYE**

### **VENDOS**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja Raportuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani